**SHOQERIA:** ***"ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE" SH.A*** **Datë, 27/03/2013**

**NIPTI:** ***K83729804 R***

**DEKLARATE**

Deklaroj se **Shoqëria** ***"ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE" SH.A*** ,me **NIPT :** ***K83729804 R*** me administrator

**Z.Elton HYSA** dhe **aksionere**:

1. **Z. Ahilea Papuçi** perqindja e pjesemarrjes **0.16%**

2. **Shoqeria: Andromeda Aquacultures International B.V**, perqindja e pjesemarrjes **99.84 %**

ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2012 komform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesi i pasqyrave financiare eshte:

Zj. **Hrisanthi Naço** **(ekonomiste e punësuar pranë shoqërisë)**

Nr. 242 prot
dt 28.03.13

**Administratori i Shoqërisë**

**Elton HYSA**

ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE Sh.a.
Vat No. K83729804R
Vlorë, Fraig, Rruga nacionale SARANDË - TIRANË
Zona Industriale, km 4

**E & B Auditing shpk**
Rr.I. Alla. P. Alba Flor Nr. 17
Tirane, Albania
Tel/Fax 042424073
Email; elza@ebauditing.com

# RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

Ortakëve të shoqërisë "Andromeda Marine Aquaculture" sh.a,
Rruga Nacionale, Sarande- Tirane, km 4, Finiq

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkalidhur të shoqerisë "Andromeda Marine Aquaculture" Sha (Shoqëria), të cilat përbëhen nga bilanci kontabel i datës 31 Dhjetor 2012, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet, dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin ushtrimor të mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

*Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

*Përgjegjësia e Audituesit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojme kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlërson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin vlerësimin e parimeve kontabile të përdorura dhe të cmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi jep një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të shoqërisë japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më daten 31 Dhjetor 2012, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur më atë datë në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar.

**E & B Auditing**

Partner

Elza Balla




21 Mars 2013

# ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE SH.A.

Pasqyrat Financiare

Per ushtrimin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2012

**PERMBAJTJA:**


BILANCI 2

PASQYRA E TE ARDHURAVE E SHPENZIMEVE 4

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE 5

PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITALET E VETA 6

**1. INFORMACION I PERGJITHSHEM 7**

**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE 7**

**3. POLITIKAT KONTABËL 8**

**4. MJETE MONETARE 12**

**5. KLIENTE DHE TE TJERA KERKESA PER ARKETIM 12**

**6. INVENTARI 12**

**7. AKTIVE BIOLOGJIKE AFATSHKURTRA 13**

**8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE 13**

**9. HUATE DHE PARAPAGIMET 14**

**10. FURNITORE E DETYRIME TE TJERA 14**

**11. SHITJET NETO 14**

**12. KOSTO E PRODUKTIT TE SHITUR 14**

**13. KOSTO FUQISë PUNETORe 15**

**14. SHPENZIME Të TJERA 15**

**15. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE 15**

**16. SHPENZIME TE PAZBRITSHME 16**

**17. TATIM FITIMI 17**

## BILANCI (GJITHE VLERAT NE LEKE)

| Emertimi | | | Shenime | 31 Dhjetor 2012 | 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | | |
| **I** | **Aktivet Afatshkurtra** | | | | |
| | 1 | **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | | | |
| | 2 | **Mjete monetare** | 4 | 1,714,227 | 396,794 |
| | 3 | **Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim** | | | |
| | I | Derivativet | | | |
| | Ii | Aktivet e mbajtura per tregtim | | | |
| **Shuma I.3** | | | | | |
| **4** | **Aktive te tjera afatshkurtra financiare** | | | | |
| | I | Llogari/Kerkesa te arketueshme | | 497,786,135 | 161,911,121 |
| | Ii | Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme | | 42,986,288 | 87,735,843 |
| | Iii | Instrumente te tjera borxhi | | | |
| | Iv | Investime te tjera financiare | | | |
| **Shuma I.4** | | | 5 | **540,772,423** | **249,646,964** |
| **5** | **Inventari** | | | | |
| | I | Lendet e para | | 4,645,391 | 2,018,579 |
| | Ii | Prodhim ne proces | | | |
| | Iii | Produkte te gatshme | | | |
| | Iv | Mallra per rishitje | | | |
| | V | Parapagesat per furnizime | | | |
| **Shuma I.5** | | | 6 | **4,645,391** | **2,018,579** |
| | 6 | **Aktivet biologjike afatshkurtra** | 7 | **56,712,971** | **235,193,755** |
| | 7 | **Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje** | | | |
| **Total** | **Aktivet Afatshkurtra** | | | **603,845,011** | **487,256,091** |
| **II** | **Aktivet Afatgjata** | | | | |
| **1** | **Investimet financiare afatgjata** | | | | |
| | I | Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata | | | |
| | Ii | Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara | | | |
| | Iii | Aksione dhe investime te tjera ne pjesmarrje | | | |
| | Iv | Aksione dhe letra te tjera me vlere | | | |
| **Shuma** | | **II.1** | | | |
| **2** | **Aktive afatgjata materiale** | | | | |
| | I | Ndertesa | | | |
| | Ii | Toka | | | |
| | Iii | Makineri dhe pajisje | | 77,591,466 | 87,344,737 |
| | Iv | Aktive te tjera afatgjata materiale | | 4,102,500 | 4,619,776 |
| **Shuma II.2** | | | | **81,693,966** | **91,964,513** |
| | 3 | **Aktivet biologjike afatgjata** | | | |
| | 4 | **Aktivet afatgjata jomateriale** | | | |
| | I | Emri i mire | | | |
| | Ii | Shpenzimet e zhvillimit | | | |
| | Iii | Aktive te tjera afatgjata jomateriale | | | |
| **Shuma II.4** | | | | | |
| | 5 | **Kapital aksionar i papaguar** | | | |
| | 6 | **Aktive te tjera afatgjata (ne proces)** | | **1,250,000** | **1,250,000** |
| | **Aktivet Afatgjata** | | 8 | **82,943,966** | **93,214,513** |
| | **Aktive TOTAL** | | | **686,788,977** | **580,470,605** |

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 6 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2013 nga:

**Administratori** — **Financiere**
**Elton HYSA** — **Hrisanthi Naço**

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a.
Vat No. K83729804R
Zona Industriale, km 4

BILANCI (Vazhdim)

| Huate dhe Kapitali | | | Shenime | 31 Dhjetor 2012 | 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|---|---|---|
| I | **Detyrimet Afatshkurtra** | | | | |
| | 1 | **Derivativet (vlera negative)** | | | |
| | 2 | **Huamarrjet** | | | |
| | i | Huat dhe obligacionet afatshkurtra | 9 | 102,878,420 | 310,066,913 |
| | ii | Kthimet/ripagesat e huave afatgjata | | | |
| | iii | Bono te konvertueshme | | | |
| **Shuma I.2** | | | | **102,878,420** | **310,066,913** |
| 3 | **Huat dhe parapagimet** | | | | |
| | i | Parapagimet e arkëtuara | | | |
| | ii | Te pagueshme ndaj furnitoreve | | 551,494,561 | 581,917,268 |
| | iii | Te pagueshme ndaj punonjesve | | 0 | 283,905 |
| | iv | Detyrimet tatimore | | 413,208 | 439,157 |
| | v | Hua te tjera | | 0 | 384,378 |
| **Shuma I.3** | | | **10** | **551,907,769** | **583,024,708** |
| | 4 | **Provizionet afatshkurtra** | | | |
| | 5 | **Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | | | |
| **Total** | **Detyrimet Afatshkurtra** | | | **654,786,189** | **893,091,622** |
| **II** | **Detyrimet Afatgjata** | | | | |
| 1 | **Huat afatgjata** | | | | |
| | i | Bonot e konvertueshme | | | |
| | ii | Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare | | | |
| **Shuma** | | **II.1** | | | |
| | 2 | **Huamarrje te tjera afatgjata** | | | |
| | 3 | **Provizionet afatgjata** | | | |
| | 4 | **Grantet dhe te ardhura te shtyra** | | | |
| **Total** | **Detyrimet Afatgjata** | | | | |
| **III** | **Kapitali** | | | | |
| 1 | **Aksionet e pakices** | | | | |
| 2 | **Kapitali qe i perket aksionareve te shoqerise meme** | | | | |
| 3 | **Kapitali aksionar** | | | **322,340,000** | **2,000,000** |
| 4 | **Primi i aksionit** | | | | |
| 5 | **Njesite ose aksionet e thesarit** | | | | |
| 6 | **Rezerva** | | | | |
| | i | Rezerva ligjore | | | |
| | ii | Rezerva te tjera | | | |
| | iii | Rezerva statuore | | | |
| **Shuma III.6** | | | | | |
| | 7 | **Fitimet e pashperndara** | | (314,621,016) | (316,029,806) |
| | 8 | **Fitimi/Humbja e vitit financiar** | | **24,283,804** | **1,408,789** |
| **Total** | **Kapitali** | | | **32,002,788** | **(312,621,017)** |
| **Totali Huate dhe Kapitali** | | | | **686,788,977** | **580,470,605** |

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 6 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2013 nga:

| | | |
|---|---|---|
| **Administratori**<br>**Elton HYSA** | ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a.<br>Nipt No. K83729804R<br>Vlorë, Fshiq. Rruga nacionale SARANDË - TIRANË<br>Zona Industriale, km 4 | **Financiere**<br>**Hrisanthi Naço** |

# PASQYRA E TE ARDHURAVE E SHPENZIMEVE
**(Gjithe vlerat ne Leke)**

| | Te Ardhura & Shpenzime<br>01/01/2012 - 31/12/2012 | Note | 2012<br>All | 2011<br>All |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Shitjet neto** | 11 | 352,382,258 | 48,787,481 |
| 2 | **Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit** | | | - |
| 3 | **Ndryshimet ne inventarin e produkteve te gatshme dhe ne proces** | | | - |
| 4 | **Materialet e konsumuara** | 12 | (282,882,785) | (30,646,350) |
| 5 | **Kosto e punes** | 13 | (7,690,724) | (5,608,485) |
| 5.1 | Paga e personelit | | (7,191,730) | (5,148,874) |
| 5.2 | Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | | (498,994) | (459,611) |
| 6 | **Amortizimi dhe zhvleresimet** | | (522,354) | (486,406) |
| 7 | **Shpenzime te tjera** | 14 | (20,975,954) | (6,842,682) |
| 8 | **Totali i shpenzimeve** | | (312,071,817) | (43,583,923) |
| 9 | **Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore** | | 40,310,441 | 5,203,558 |
| 10 | **Te ardhura dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrollit** | | | - |
| 11 | **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet** | | | - |
| 12 | **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga:** | 15 | (16,026,637) | (17,158,081) |
| 12.1 | Investime te tjera financiare afatgjate | | | |
| 12.2 | Interesa | | (14,544,999) | (18,476,609) |
| 12.3 | Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit | | (1,316,957) | 1,736,197 |
| 12.4 | Te tjera financiare | | (164,681) | (417,669) |
| 13 | **Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare** | | (16,026,637) | (17,158,081) |
| 14 | **Te ardhura e shpenzime te pacaktuara** | | 0 | 13,363,312 |
| 15 | **Fitimi(humbja) para tatimit** | | 24,283,804 | 1,408,789 |
| 16 | **Shpenzimet e tatimit mbi fitimin** | 18 | | - |
| 17 | **Fitimi (humbja) neto e vitit financiar** | | 24,283,804 | 1,408,789 |
| 18 | **Elementet e pasqyrave te konsoliduara** | | | |

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 6 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2013, nga:

**Administratori**
**Elton HYSA**

ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE Sh.a.
Vat No. K83729804R
Vlorë, Fshat. Rruga nacionale SARANDË-TIRANË
Zona Industriale, km 4

**Financiere**
**Hrisanthi Naço**

## PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
**(Gjithe vlerat ne Leke)**

| **Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit** | **2012 LEK** | **2011 LEK** |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 24,283,804 | 1,408,789 |
| Rregullime per ; | 11,465,652 | (1,105,452) |
| Amortizimin | 11,465,652 | (1,105,452) |
| Humbje nga kembimet valutore | | - |
| Te ardhura nga investimet | | - |
| Shpenzime per interesa | | - |
| | | |
| Rritje / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti si dhe kerkesave te arketueshme te tjera | (289,261,575) | 11,015,082 |
| Rrite/ renie ne tepricen e inventarit | 175,853,972 | (148,338,328) |
| Rritje/ renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti | (31,116,939) | 135,755,585 |
| Parate e perfituara nga aktivitetet | | |
| Interes I paguar | | - |
| Tatim fitimi I paguar | (1,863,884) | (110,000) |
| | | |
| **Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit** | **(110,638,969)** | **(1,374,324)** |
| | | |
| **Fluksi monetar nga veprimtarite investuese** | | |
| Blerja e aktiveve afatgjata materiale | (1,195,106) | (8,307,990) |
| Te ardhura nga shitja e pajisjeve | | - |
| Interes I arketuar | | - |
| Dividente te arketuar | | - |
| **Fluksi monetar neto nga veprimtaria investuese** | **(1,195,106)** | **(8,307,990)** |
| | | |
| **Fluksi monetar nga veprimtarite financiare** | | |
| Te ardhura nga emetimi I kapitalit aksionar | 320,340,000 | - |
| Mjete monetare te arketuara nga kredi | (207,188,493) | 8,189,431 |
| Pagesat e detyrimeve te qirase financiare | | - |
| Dividentet e paguar | | - |
| | | |
| **Fluksi monetar neto nga aktivitetet financiare** | **113,151,507** | **8,139,431** |
| | | |
| Rritja/ renia neto e mjeteve monetare | **1,317,433** | **(1,492,883)** |
| Mjetet monetare ne fillim te periudhes | 396,794 | 1,889,677 |
| **Mjetet monetare ne fund te periudhes** | **1,714,227** | **396,794** |

Pasqyrat financiare nga faqja ... dhe miratuar me 28 Shkurt 2013 nga:

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a.
...t No. K83729804R
Vlorë, Rruga nacionale SARANDË - TIRANË
Zona Industriale, km 4

**Administrator**
**Elton HYSA**

**Financiere**
**Hrisanthi Naço**

## PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITALET E VETA
**(Gjithe vlerat ne Leke)**

| | Kapitali aksionar | Primi I aksionit | Rezerva Ligjore | Fitime Humbje te mbartura | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| | **LEK** | **LEK** | **LEK** | **LEK** | **LEK** |
| Bilanci date 31 Dhjetor 2011 | **2,000,000** | - | - | **(314,621,017)** | **(312,621,017)** |
| | 320,340,000 | | | | 320,340,000 |
| Emetim I kapitalit aksionar | - | - | - | - | - |
| Divident i paguar | - | - | - | - | - |
| Fitim Humbje te mbartura | - | - | - | - | - |
| Humbje / Fitim per periudhen | - | - | - | 24,283,804 | 24,283,804 |
| **Bilanci date 31 Dhjetor 2012** | **322,340,000** | | | **(290,337,213)** | **32,002,788** |

Pasqyrat financiare nga faqja 2 deri 6 jane firmosur dhe miratuar me 28 Shkurt 2013 nga:

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a.
No. K83729804R
Zona Industriale, km 4

**Administrator**
**Elton HYSA**

**Financiere**
**Hrisanthi Naço**

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

"Andromeda Marine Aquaculture" sh.a (shoqeria) eshte krijuar ne baze te Vendimit Nr. 38554 date 13.06.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane si dhe regjistrimit te Qendres Kombetare te Rregjistrimit Tirane date 08.05.2007, ne perputhje me ligjin "Per Shoqerite Tregtare" nr.9901 datë 14.04.2008.
Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte kultivimi rritje dhe tregtimi I peshkut, krijimi I nje qendre kerkimore, import, export.

Aksioneret e shoqerise jane si me poshte:

| | Emri I aksionereve | Aksionet e zoteruara | Vlera e kapitalit '000 leke | % ne kapital |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Andromeda Aquaculture International B.V. | 3,218,420 | 321,842 | 99.84% |
| 2 | Arqile Papuci | 4,980 | 498 | 0.16% |

Kapitali I nenshkruar I shoqerise eshte 322,340,000 leke i ndare ne 3,223,400 aksione me vlere nominale 100 leke

Administratore te shoqerise jane: Z. Elton Hysa dhe Z.Ioannis Karvelas.

Numri mesatar I te punesuarve me 31 Dhjetor 2012 eshte 14. (me 31 Dhjetor 2011 ishte 14).
Selia e shoqerise eshte Rruga Nacionale, Sarande- Tirane, km 4, Finiq.
Shoqeria eshte e regjistruar ne Njesine e Tatim paguesve te rrethit Sarande me NIPT:K83729804R.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

### a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Paqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga regullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Paqsyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

### b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### c. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a. No. K83729804R Vlorë, Rruga Nacionale SARANDË-TIRANË Zona Industriale, km 4

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerisë.

### d. Vleresime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varësi te ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura ne periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësine e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

## 3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtëme janë aplikuar për periudhën qe fillon me 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012.

### a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes se transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj jane si me poshte (ne LEK):

| | 31 Dhjetor 2012 | 31 Dhjetor 2011 |
|---|---|---|
| 1 EUR | 139.59 | 138.93 |
| 1 USD | 105.85 | 105 |

ANDROMEDA MARINE AQUACULTURE Sh.a.
No. K83729804R
Vlorë, Rruga Nacionale SARANDË-TIRANË
Zona Industriale, km 4

### b. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime ne kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

*Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje ne pagesa (mbi 30 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv .

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Kapitali aksioner*

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshmë me të drejtë riblerjeje klasifikohen si d



ANDROMEDA MARINE
TURE Sh.a.
K83729804R
SARANDË-TIRANË
Zona Industriale, km 4

### c. Aktive e afatgjata materiale dhe jomateriale

*(i) Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në "Ndërtim në proces" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

*(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar të cdo pjese të aktivit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore te amortizimit te perdorura jane si me poshte:

| **Kategoria** | **Norma e amortizimit %** | | **Metoda e llogaritjes** |
|---|---|---|---|
| | **2012** | **2011** | |
| Instalime | 12 | 12 | Vlera kontabile e mbetur |
| Mjete transporti | 12 | 12 | |
| Mobilje orendi | 15 | 15 | |
| Paisje elektronike | 15 | 15 | |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi.

### d. Zhvlerësimi

*(i) aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që [illegible] një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që pa[illegible] të burojnë nga aktivi

ANDROMEDA MARINE
AQUACULTURE sh.a.
No. K83729804R
Vlorë, Lungomare, Rruga nacionale SARANDË-TIRANË
Zona Industriale, km 4

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(ii)* *Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale jane njohur si te tilla nese parashikohet qe shoqeria do te kete perfitime te ardhshme ekonomike qe kane lidhje me ate aktiv dhe kosto e aktivit mund te matet ne menyre te besueshme. Vlera e mbajtjes se aktiveve te qendrueshme duhet te rishikohet nese eshte zhvleresuar kur ndodhin ndryshime ose ndryshime ne rethanat tregojne se vlera e mbajtjes mund te jete e parikuperueshme. Nese keto te dhena ekzistojne dhe atehere kur vlera e mbajtjes kalon vleren e parashikuar te rikuperueshme, aktivi zhvleresohet ne vleren e rikuperueshme dhe humbja nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

### e. Njohja e te ardhurave dhe shpenzimet

Te ardhurat jane njohur atehere kur shoqeria do te kete te mundur te marre perfitime ekonomike dhe keto perfitime mund te vleresohen me siguri (dhe jo domosdoshmerisht kur eshte arketuar). Shpenzimet jane njohur ne pasqyren e te ardhura-shpenzimeve atehere kur kane ndodhur (dhe jo domosdoshmerisht kur eshte paguar). Te ardhurat dhe shpenzimet jane regjistruar ne pasqyrat financiare te periudhes se ciles ato i perkasin.

### f. Të ardhura dhe shpenzime financiare

